



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 244, Datë 30.09.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“VIVID POWER” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2467/1 prot., datë 23.09.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Vivid Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467 prot., datë 17.09.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, gërmat “a” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; si dhe për pikën 2.4, gërmat “a” dhe “b”.
- Shoqëria duhet të plotësojë më tej informacionin/dokumentacionin si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.1. Format i aplikimit, sipas përcaktimeve të Shtojcës 1.

gërma b: Rezulton se shoqëria ka plotësuar NIPT-in dhe emrin e subjektit për një shoqëri të ndryshme nga shoqëria aplikuese, ndaj duhet të ridepozitojë Shtojcën 1 me saktësimet përkatëse. *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të shlyejë detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të depozitojë në ERE një vërtetim të përditësuar.
- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë një vendim të organeve drejtuese për të dedikuar vlerat respektive në kuadër të financimit të secilës prej veprimtarive (duke qenë se ka aplikuar paralelisht dhe për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike) si dhe të depozitojë dokumentacion vërtetues për disponimin e pjesë së mbetur të mbështetjes financiare.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit për 5 vite, ku të përfshihet dhe mënyra e financimit të veprimtarisë.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të sqarojë/dokumentojë mënyrën se si i disponon zyrat përfaqësuese të furnizuesit.
- **gërma “d”:** Shoqëria duhet të sjellë informacion mbi nivelin e tension që parashikon të furnizojë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI